



Makerspace
Innovation Center
Prizren



**Aneks marrëveshje bashkëpunimi
në mes të:**

**Supplement/annex cooperation agreement
between:**

Komuna e Prizrenit / Prizren Municipality

Me seli në / With the registered seat at

Rr/Str: Remzi Ademaj p.n

Përfaqësuar nga / Represented by

Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës/Mayor

(tutje referuar si – “Komuna”; hereinafter “Municipality”)

dhe / and

Makerspace – Innovation Center Prizren

Me seli në / With the registered seat at

Prizren, rr/str: Ukë Bytyçi, U22, ITP Prizren

Përfaqësuar nga / Represented by

Enis Qafëleshi, Drejtor Ekzekutiv / Executive Director

(tutje referuar si – “MICP”; hereinafter “MICP”)

 Makerspace Innovation Center Prizren	
Pranuar me dt. 23.02.2024	
Zyra e pranimat	Nr i protokolit
Administrata	040/2024

dhe / and

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V.

Me seli në / With the registered seat at

Prishtinë, Ulpiana, rr/str: Zija Shemsiu 102/9

Përfaqësuar nga / Represented by

Shqipe Breznica, Drejtoreshe Nacionale/Country Director

(tutje referuar si – “Help”; hereinafter “Help”)

	
REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA KOSOVA CUMHURIYETI Komuna e Prizrenit * Opština Prizren Prizren Beledijesi Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine Belediye Başkanı	
01	Nr. 129/24 Dt. 23.02.2024

Në kuadër të projektit

“Programi i trajnimit për punësim - Shkathtësi Digjitale”

Within the project

“Training-to-employment - Digital Skills Program”

Neni 1. / Article 1.

Subjekt i aneks marrëveshjes / Subject of the annex agreement

Bazuar në Nenin 3, Pika 4 dhe Neni 14, Pika 1.4, të Rregullores Komunale Nr: 001-011-201 të datës 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Transfereve dhe Grantëve dhe duke u bazuar në marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit në mes të të Komunës së Prizrenit, organizatës Help dhe Makerspace Innovation Center Prizren në kuadër të projektit "Programi i Trajnimit për Punësim – shkathtësi digjitale" (më tej "Projektit"), të datës 07.04.2023 e cila rregullon bashkëpunimin dhe bashkëfinancimin e projektit, subjekt i kësaj aneks marrëveshje (më tej: aneks) është zgjatja dhe rregullimi i bashkëpunimit në mes të palëve për vitin 2024.

Projekti do të vazhdojë të realizohet përgjatë vitit 2024. Të tre palët/partnerët do të bashkëpunojnë në çështjet e mëposhtme gjatë zbatimit të projektit:

- Ofrimin dhe promovimin e programit në të gjitha kanalet e komunikimit publik,
- Shkëmbimin e kërkesave për participim në program nga kanalet gjegjëse të komunikimit,
- Krijimin e partneriteteve me kompani vendore dhe të huaja për pjesëmarrjen në punësim,
- Krijimin e drejtpërdrejtë të vendeve të punës.

Based on the existing cooperation agreement between the Municipality of Prizren, Help and Makerspace Innovation Center Prizren within the project "Training Program for Employment - digital skills" (hereinafter "the Project"), dated 04.07.2023, which regulates cooperation and co-financing of the project, the subject of this annex agreement (further: annex) is the extension and regulation of cooperation between the parties for the year 2024.

The project will continue to be implemented throughout the year 2024. The three parties/partners will cooperate in the following issues during the implementation of the project:

- *Providing and promoting the program in all public communication channels,*
- *Exchange of requests for participation in the program by the respective communication channels,*
- *Creating partnerships with local and foreign companies for participation in employment,*
- *Direct creation of jobs.*

Neni 2. / Article 2.

Shpjegim i shkurtër i projektit / Short explanation of the Project

Projekti "Programi i trajnimit për punësim – shkathtësi digjitale - PowerUp" synon të ofrojë ndihmë të rinjve të papunësuar, nën punësuar dhe të papërcaktuar profesionalisht që të orientojnë zhvillimin e tyre profesional drejt përvetësimit të shkathtësive digjitale inovative, në mënyrë që t'u ofrojë mundësi punësimi përfituesve.

Përkrahja do t'u ofrohet të rinjve të regjionit të Prizrenit pa dallim, përmes ndërtimit të aftësive personale dhe profesionale si dhe fuqizimit të tyre ekonomik. Në kuadër të projektit do të mbështeten gjashtëdhjetë (60) të rinj në synimet e tyre për të filluar karrierë në fushat e shkathtësive digjitale.

Mbështetja do të përfshijë këto programe/aktivitete:

- 1) Programi/Aktiviteti 1: Sigurimin e pajisjeve bazë të punës për pjesëmarrësit (laptop dhe të ngjashme) për t'u përdorur përgjatë projektit në vlerë prej 15,000.00 Eur.
- 2) Programi /Aktiviteti 2: Sigurimin e një hapësire pune individuale për çdo përfitues deri në fund të programit, në vlerë prej 24,000.00 Eur.
- 3) Programi /Aktiviteti 3: Trajnimin në fushën profesionale për përfituesit në kohëzgjatje prej (6) muajsh, në vlerë prej 41,000.00 Eur.
- 4) Programi /Aktiviteti 4: Trajnimin adekuat në shkathtësi të buta dhe të nevojshme për gjetjen e një vendi të punës, në vlerë prej 30,000.00 Eur.
- 5) Programi /Aktiviteti 5: Mentorimin profesional të përfituesve nga ekspertë të kompanive partnere, në vlerë prej 28,000.00 Eur.
- 6) Programi /Aktiviteti 6: Përcjelljen e suksesit të përfituesve dhe facilitimin e punësimit për ta, në vlerë prej 5,000.00 Eur.

Zbatimi i përgjithshëm i aktiviteteve të projektit do të bëhet nga MICP, me kontribut vetanak në vlerë prej 35,000.00 Eur në programet/aktivitetet 1, 2, 5 dhe 6.

Komuna e Prizrenit do të financojë për vitin 2024 një vlerë të përgjithshme prej 98,000.00 Eur në programet/aktivitetet: Programi/Aktiviteti 2 (17,000.00 Eur), Programi/Aktiviteti 3 (36,000.00 Eur), Programi/Aktiviteti 4 (25,000 Eur) dhe Programi/Aktiviteti 5 (20,000.00 Eur).

Organizata Help ka respektuar me përkushtim marrëveshjen themelore, duke ofruar mbështetje të projektin me një kontribut prej 10,000.00 Eur si për vitin 2023 ashtu edhe për vitin 2024. Këto fonde u transferuan menjëherë në llogarinë MICP për ekzekutimin e programeve/aktiviteteve 3,4 dhe 6 të projektit siç specifikohet në kushtet e marrëveshjes. Aktualisht, organizata Help ka përmbushur në mënyrë të përsosur të gjitha angazhimet financiare të përcaktuara në kontratën themelore të nënshkruar më 12.04.2023, me numër protokollit 001/23/076.

The project "Training-to-employment– Digital Skills Program - PowerUp" aims to provide support to unemployed, underemployed, and professionally undefined young people to orient their professional development towards the acquisition of innovative digital skills, to provide employment opportunities to the beneficiaries.

Support will be offered to the youth of the Prizren region without distinction, through the building of personal and professional skills as well as their economic empowerment. Within the project, sixty (60) young people will be supported in their goals to start a career in the fields of digital skills.

The support will include the following programs/activities:

- 1) Program/Activity 1: Provision of basic work equipment for participants (laptop and similar) to be used throughout the project in the amount of 15,000.00 Eur.*
- 2) Program/Activity 2: Provision of an individual workspace for each beneficiary until the end of the program, in the amount of 24,000.00 Eur.*
- 3) Program/Activity 3: Training in the professional field for the beneficiaries for a duration of (6) months, in the amount of 41,000.00 Eur.*
- 4) Program/Activity 4: Adequate training in soft skills and necessary for finding a job, in the amount of 30,000.00 Eur.*
- 5) Program/Activity 5: Professional mentoring of the beneficiaries by experts from partner companies, in the amount of 28,000.00 Eur.*
- 6) Program/Activity 6: Conveying the success of the beneficiaries and facilitating employment for them, in the amount of 5,000.00 Eur.*

The overall implementation of the project activities will be done by MICP, with its own contribution in the amount of 35,000.00 Eur in programs/activities 1, 2, 5 and 6.

The Municipality of Prizren will finance for the year 2024 a total value of 98,000 Eur in the programs/activities: Program/Activity 2 (17,000.00 Eur), Program/Activity 3 (36,000.00 Eur), Program/Activity 4 (25,000 Eur) and Activity 5 (20,000.00 Eur).

The Help organization has dutifully honored the foundational agreement, providing substantial support to the project with a contribution of €10,000.00 for both 2023 and 2024. These funds were promptly transferred to the MICP account to facilitate the execution of project activities outlined in programs/activities 3, 4, and 6 as specified in the agreement terms. Presently, the Help organization has impeccably met all financial commitments outlined in the fundamental contract signed on 12.04.2023, under protocol number 001/23/076.

Neni 3. / Article 3.

Financimi i projektit

Palët pajtohen për financimin e projektit si në vijim:

Komuna dhe Help do të transferojnë shumat përkatëse të pjesëmarrjes në drejtim të zbatimit të projektit. Kontributi transferohet në llogarinë bankare të MICP:

Emri i përfituesit: Makerspace – Innovation Center Prizren

Nr.xhirollogarisë: 1910000466031114

Banka: BKT Kosova

MICP merr përsipër të përdorë kontributin vetëm për objektivat e Projektit. MICP është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe kontributin e dhënë ta përdorë në mënyrë të duhur. Kontributet nga të gjithë donatorët do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e Projektit. Procedurat e prokurimit do të udhëhiqen sipas rregulloreve të standardizuara të MICP në bashkërendim me donatorët e përfshirë në projekt.

MICP merr përgjegjësinë për menaxhimin e përgjithshëm të Projektit dhe do të raportojë mbi mënyrën e shfrytëzimit të kontributeve tek secila palë kontribuuese.

MICP do të aplikojë qasje transparente përgjatë zbatimit të projektit ku përfaqësuesi/ja nga Komuna dhe Help do të jenë pjesë integrale dhe aktive përgjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit.

The parties agree on the financing of the project as follows:

Municipality and Help will transfer the corresponding sums of participation towards the implementation of the project. The contribution is transferred to the MICP bank account:

Name of the beneficiary: Makerspace – Innovation Center Prizren

Account number: 1910000466031114

Bank: BKT Kosova

MICP undertakes to use the contribution only for the objectives of the Project. MICP is responsible for the implementation of the project and to use the given contribution properly. Contributions from all donors will be used exclusively for the implementation of the Project. The procurement procedures will be guided according to the standardized regulations of the MICP in co-ordination with donors involved in the project.

MICP takes responsibility for the overall management of the Project will report on the way of using the contributions to each contributing party.

MICP will apply a transparent approach during the implementation of the project where the representative from the Municipality and Help will be an integral and active part during the implementation of the project activities.

Neni 4. / Article 4.

Monitorimi dhe Raportimi / Monitoring and Reporting

Palët emërojnë stafin për monitorimin e këtij projekti. Në lidhje me aktivitetet në kuadër të projektit, MICP do të paraqesë një raport përfundimtar sipas formave përkatëse të partnerëve brenda tre muajve nga data e përfundimit të Projektit. Palët bien dakord për shkëmbimin e informacionit në kuadrin e Projektit gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të tij.

Parties nominate staff for the monitoring of this Project. Regarding activities within the project, MICP will submit a final report (narrative and financial) within three months from the completion of the Project. Parties agree to always exchange information within the framework of the Project during its implementation.

Neni 5. / Article 5.

Klauzolë në konfidencialitet / Clause on confidentiality

Palët bien dakord për konfidencialitetin e të gjitha të dhënave të përdorura brenda kuadrit të bashkëpunimit. Të gjitha dokumentet dhe informatat do të mbeten vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, pa miratimin me shkrim nga Komuna, Help dhe MICP.

Parties agree on the confidentiality of all data used within the frame of the cooperation. All documents and information shall remain for internal use only and cannot be used for other purposes without written approval from Municipality, Help and MICP.

Neni 6. / Article 6.

Kohëzgjatja, ndryshimet e MB / Duration, changes of the CA

Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe do të përfundojë në 31 dhjetor 2024 me mundësi të ndryshohet dhe të amendamentohet me anekset e shkruara siç është propozuar nga nënshkruesit.

The Agreement will come into force on the day of its signing and will expire on 31 December 2024 with the possibility to be changed and amended by written annexes, as proposed by the signatories.

Neni 7. / Article 7.

Mosmarrëveshjet / Disputes

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet nënshkruesve të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mënyrë miqësore me marrëveshje të përbashkët dhe në vullnet të mirë. Nëse një zgjidhje miqësore nuk mund të arrihet të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen përfundimisht para gjykatës kompetente.

Any disputes between the signatories arising out of this agreement shall be settled amicably by mutual agreement and in good will. If an amicable settlement cannot be reached all disputes shall be finally settled before the competent court.

Neni 8. / Article 8.

Gjuha / Language

Kjo marrëveshje është përgatitur në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe e nënshkruar në gjashtë (6) kopje identike, të cilat secili nënshkrues mban nga dy kopje.

This agreement has been prepared parallel in two languages (Albanian and English), and signed in six (6) identical copies, of which each signatory retains two copies.

Data/Date: 23/02/2024

Në/in: Prizren


Komuna e Prizrenit

Makerspace Innovation Center Prizren

Help - Hilfe zur Selbsthilfe


Shaqir Totaj
Kryetar i Komunës
Municipality Mayor


Enis Qafleshi
Drejtor Ekzekutiv
Executive Director


Shqipe Breznica
Drejtoreshë Nacionale
Country Director